

VENDIM
Nr. 53, datë 8.7.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 8.7.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (Sh) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “METEO” SHPK, përfaqësuar nga avokat Ervin Metalla, me prokurë.

SHOQËRIA “NG STRUCTURES” SHPK, përfaqësuar nga avokat Ervin Metalla, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Genc Gjonçaj, sekretar i përgjithshëm.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Engjëll Agaçi, sekretar i përgjithshëm.

BASHKIA E TIRANËS, përfaqësuar nga Alban Dokushi, drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, datë 3.5.2018, “Për strehimin social”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 42, 43, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 31/a, 49, pikat 3, shkronja “e” dhe 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes së paraqitur nga kërkuueset, mendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë së Tiranës, si dhe diskutoi çështjen,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Më datë 3.5.2018, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social” (*ligji për strehimin social*), i cili përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së programeve sociale për strehim. Neni 19 i tij parashikon rregullat për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik, me këtë përmbajtje: “1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të

jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. 2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.”.

2. Këshilli Bashkiak i Tiranës, mbështetur, ndër të tjera, edhe në nenin 19 të ligjit për strehimin social, ka miratuar vendimin nr. 105, datë 25.10.2019, “Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë së Tiranës nga ndërtimet reja” (VKB nr. 105/2019). Sipas këtij vendimi, çdo zhvillues privat që ka aplikuar pas datës 30.11.2018 për leje ndërtimi me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 m², për nevoja të fondit publik të banesave sociale detyrohet të kalojë pa shpërblim në favor të Bashkisë së Tiranës 3% të sipërfaqes funksionale ndërtimore në pronësi të investitorit/zhvilluesit (pika 1). Sipërfaqja që detyrohet të dorëzojë subjekti privat për strehimin social sigurohet në objektin për të cilin aplikohet për leje ndërtimi ose në një objekt tjetër në pronësi të tij, ose mund të paguhet në vlerë leku (pikat 2, 3 dhe 6).

3. Më datë 2.7.2019, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e nenit 19 të ligjit në fjalë si antikushtetues. Megjithatë, kërkesa është rrëzuar nga Gjykata me vendimin nr. 21, datë 28.4.2021, për shkak se ishte paraqitur nga përfaqësues të palegjitimuar rregullisht, e metë e cila nuk u korrigjua nga kërkuesja edhe pse iu la kohë në dispozicion.

4. Pas disa vitesh, konkretisht më datë 22.6.2023, ligji për strehimin social ka pësuar disa ndryshime të miratuara me ligjin nr. 48/2023. Pas ndryshimeve, në nenin 19 është shtuar pika 3 me këtë përmbajtje: “Rregullat e zbatimit të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”. Në zbatim të kësaj pike, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 325, datë 29.5.2024, “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”, i cili ka detajuar rregullat për kontributin e sektorit privat për krijimin e fondit publik të banesave sociale, në përputhje me përcaktimet e nenit 19 të ligjit për strehimin social.

5. Kërkueset, në cilësinë e shoqërive tregtare, me veprimtari në fushën e ndërtimit, më datë 15.12.2022 i janë drejtuar Bashkisë së Tiranës për dhënien e lejes së ndërtimit për një kompleks ndërtesash me sipërfaqe totale banimi 11 142.5 m², të ndodhur në Farkë, Tiranë. Leja e ndërtimit është miratuar nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, më datë 3.10.2023.

6. Në vijim, kërkueset, bazuar në nenin 19 të ligjit për strehimin social, kanë nënshkruar deklaratën noteriale të datës 30.11.2023 për konfirmimin e detyrimit ndaj bashkisë për kalimin 3% të ndërtimit në favor të saj pa kundërshtpërblim, për sipërfaqen takuese prej 334.3 m², si dhe marrëveshjen noteriale të datës 11.1.2024, me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës.

7. Më datë 2.2.2024, kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili pas plotësimit me dokumentet e kërkuara, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar përfundimisht më datë 14.2.2024. Kolegji i Gjykatës, i mbledhur më datë 18.4.2024, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 25.4.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

8. Pas kalimit të çështjes në seancë plenare, administratorët e dy shoqërive kërkuese kanë paraqitur në Gjykatë deklaratën e përbashkët noteriale të datës 1.6.2024, me të cilën kanë deklaruar heqjen dorë nga shqyrtimi i kërkesës për shfuqizimin e nenit 19 të ligjit për strehimin social si antikushtetues. Në këto rrethana, mbështetur në nenin 31, pika 4, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, është caktuar shqyrtimi me përparësi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkeset, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se detyrimi i parashikuar në neni 19 të ligjit për strehimin social nuk respekton parimin e proporcionalitetit, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, të lidhur me:

9.1 *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi vështirëson aktivitetin privat, duke i detyruar sipërmarrësit të japin falas pjesë të objektit që si destinacion të vetëm ka fitimin ekonomik. Detyrimi nuk merr parasysh aftësitë e individit për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende; lirinë nga ndërhyrjet e shtetit; lirinë e investimit dhe qarkullimit të kapitaleve; lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror; lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti. Masa fikse e detyrimit minimal prej 3% është e paarsyeshme, prek thelbin e veprimtarisë ekonomike dhe nuk i përgjigjet qëllimit për të cilin vendoset. Detyrimi, ndonëse është vendosur për interesin publik të strehimit të qytetarëve që nuk kanë mundësi financiare të mjaftueshme, nuk është proporcional. Caktimi i masës së detyrimit nuk mban parasysh asnjë rregull financiar dhe biznesi të ekonomisë së tregut, asnjë interes të investitorëve, sipërmarrësve dhe blerësve të banesave, si dhe nuk përfill asnjë detyrim financiar që subjektet i paguajnë bashkisë kur aplikojnë për leje ndërtimi. Po kështu, detyrimi e kalon barrën për strehim nga shteti tek privati pa kriteret e arsyeshme dhe duke e kushtëzuar me lejen e ndërtimit në një formë që dëmton dhe demotivon sektorin privat. Detyrimi i shton barrën të paarsyeshme sektorit privat mbi detyrimet e zakonshme.

9.2 *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi i detyron subjektet të tjetërsojnë pronën kundër dëshirës, planifikimit të tyre financiar dhe jo sipas mundësive të tyre. Detyrimi i parashikuar me ligj imponon disponimin e pronës në favor të një subjekti të tretë – bashkisë, që nuk është palë në kontratën e sipërmarrjes, por hyn më pas në një marrëdhënie juridike-civile pa pasur titull. Parashikimi i dispozitës, në thelb, barazohet me shpronësim të detyruar, të paligjshëm dhe arbitrar, sepse është veprim që bëhet tërësisht kundër vullnetit të pronarit dhe nuk shoqërohet me shpërblim, duke u konsideruar “kontribut”/”kalim pa shpërblim”. Për nga natyra, ky detyrim barazohet me dhurimin, për pasojë cenohet edhe e drejta e disponimit, pasi dhurimi i pronës bazohet në vullnetin e lirë dhe bëhet për arsye që vetë dhuruesi i vlerëson të tilla.

10. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në mënyrë të përmbledhur, në prapësimet e tij ka parashtruar, si vijon:

10.1 Kërkeset *nuk legjitimohen* në paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Ato nuk justifikojnë interesin në paraqitjen e kërkesës, sepse dispozita e kundërshtuar ka pësuar ndryshime përpara kohës së miratimit të lejes së ndërtimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve. Pas ndryshimeve, ajo autorizon Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore, ndaj nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme. Gjithashtu, kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit, që përkon me datën e nënshkrimit të deklarates noteriale, ku ato kanë shprehur vullnetin se pranojnë që të japin 3% të sipërfaqes ndërtimore për fondin social të banesave. Po kështu, kërkeset janë shoqëri tregtare që ushtrojnë prej vitesh veprimtarinë e tyre, ndaj prezumohet se janë pajisur me leje ndërtimi edhe më herët se rasti konkret, ndaj, edhe për këtë arsye ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit.

10.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike* nuk qëndron, pasi neni 19 i ligjit për strehimin social e kufizon këtë liri për interes publik dhe në mënyrë proporcionale. Ligji i jep mundësi ndërtuesit/zhvilluesit të zgjedhë ndërmjet disa alternativave kufizimin më të vogël, duke mos i penguar në këtë mënyrë aktivitetin ekonomik fitimprurës, si dhe duke mos i humbur asnjë pjesë funksionale në sipërfaqe ose shfrytëzim të saj si investim konkret aktual. Gjithashtu, ai parashikon edhe alternativa të tjera më të buta për zbatimin e kushtit prej 3%. Po kështu, pas ndryshimeve ligjore është parashikuar mundësia e ofrimit të kontributit në të holla, alternativë kjo e parashikuar edhe nga pikat 6 dhe 7 të VKB-së nr. 105/2019.

10.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi dispozita e kundërshtuar nuk synon shpronësimin e shoqërive që marrin leje për zhvillimin e një prone. Atyre nuk u mohohet ushtrimi i së drejtës së gëzimit dhe të disponimit të objektit që do të ndërtohet, por në funksion të shtetit social dhe interesit publik parashikohet një mënyrë kontributi në mbështetje të shtresave në nevojë, ku shteti ka përgjegjësi për realizimin faktik të së drejtës së strehimit. Neni 19 i ligjit për strehimin social është një mekanizëm ligjor për strategjinë e duhur sociale për të siguruar

që rishpërndarja e mjeteve financiare midis grupeve të ndryshme të popullsisë të orientohet nga parimi i drejtësisë sociale.

11. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, në prapësimet e tij ka parashtruar, si vijon:

11.1 Kërkueset *nuk legjitimohen* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi nuk justifikojnë interesin në kushtet kur dispozita ligjore objekt kundërshtimi nuk zbatohet drejtpërdrejt, por parashikon nxjerrjen e aktit nënligjor për zbatimin e saj. Po kështu, ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit, sepse prezumohet se kërkueset pas vitit 2018 janë pajisur me leje ndërtimi, ndaj e kanë konstatuar cenimin e të drejtave më herët. Gjithashtu, kërkueset nuk kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sepse pretendimet e tyre, në thelb, lidhen me marrëveshjen e datës 11.1.2024, e cila mund të kundërshtohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përpara se kërkueset t'i drejtoheshin Gjykatës.

11.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike* është i pabazuar, pasi ndërhyrja ka qenë e justifikuar për shkak të interesit publik dhe proporcional në raport me qëllimin legjitim. Kufizimi nuk e rëndon pozitën dhe interesat ekonomike të subjekteve ndërtuese në treg, pasi nuk vendos detyrim për subjektet që nuk kanë kapacitete për të ndërtuar sipërfaqe të mëdha, mbi 2 000 m². Masa 3% është proporcionale dhe nuk prek ose dëmton interesat pasurorë të subjekteve. Ndërhyrja ka marrë në konsideratë praktikën më të mirë të vendeve evropiane në këtë drejtim.

11.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* nuk qëndron, pasi kërkueset nuk gjenden në kushtet e shpronësimit. Masa ka për qëllim ofrimin e drejtësisë shoqërore, si pjesë e reformës në drejtim të sigurimit të strehimit social dhe është proporcionale referuar qëllimit të ndërhyrjes.

12. Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës, në mënyrë të përmbledhur, në prapësimet e tij ka parashtruar, se kërkueset *nuk legjitimohen* në aspektin formal dhe procedural, pasi mungon interesi i ligjshëm dhe vlefshmëria e kërkesës. Ato vetë kanë shprehur vullnetin me nënshkrimin dhe depozitimin e deklaratës noteriale për dhënien e pëlqimit të lirë dhe të pavesuar për kalimin pa shpërblim në favor të Bashkisë së Tiranës për programin e strehimit social të sipërfaqes takuese të ndërtimit prej 3% për të cilën janë pajisur me lejen përkatëse të ndërtimit, duke nënshkruar edhe marrëveshjen për këtë qëllim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

13. Më datë 1.6.2024, dy shoqëritë ndërtuese, që kanë vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, nëpërmjet administratorëve respektivë, kanë nënshkruar një deklaratë të përbashkët noteriale, në të cilën janë shprehur: “*nën përgjegjësinë tonë personale dhe ligjore, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i rremë se heqim dorë nga kërkesëpadia në lidhje me çështjen më objekt: “Shfuqizimi si antikushtetues i nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, duke mos pasur asnjë pretendim të mëtejshëm. Për sa më sipër e bëjmë këtë deklaratë me qëllim paraqitjen e saj pranë çdo institucioni ku të çmohet e nevojshme.”*. Deklarata është depozituar në Gjykatë më datë 4.6.2024, nëpërmjet shërbimit postar dhe u është komunikuar të gjitha palëve pjesëmarrëse në gjykim.

14. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes bazuar në nenin 31/b, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, për shkak të heqjes dorë të kërkueseve. Ndërsa subjektet e tjera të interesuara, Kuvendi dhe Bashkia e Tiranës, nuk janë shprehur lidhur me këtë deklaratë.

15. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku, sipas nenit 16, pika 2, të Kushtetutës, përfshihen edhe personat juridikë, sikurse shoqëritë tregtare në këtë gjykim. Ndërsa neni 31/b i ligjit nr. 8577/2000 parashikon të drejtën e kërkuesit të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila për këtë shkak vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Heqja dorë nga kërkesa nuk pranohet kur Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes paraqet interes publik. Ndërsa pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë

të drejtë kërkesit në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata, por pa u shprehur për mënyrën se si vendos Gjykata në këtë rast.

16. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Gjykata evidenton se për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues vepron parimi i disponibilitetit, sipas të cilit kërkesit i njihet e drejta që procedurën e filluar prej tij ta ndërpresë përmes aktit të heqjes dorë. Ky i fundit, si rregull, passjell pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur shqyrtimi i saj mbart interes publik.

17. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata çmon se duhet të analizojë nëse: (i) deklarata noteriale përbën kërkesë për heqjen dorë të kërkueseve nga ankimi kushtetues individual i tyre; (ii) shqyrtimi i çështjes mbart interes publik, në kuptimin që të zbatohet rregulli përjashtimor i parimit të disponibilitetit.

18. Lidhur me çështjen e parë, Gjykata vëren se deklarata noteriale është paraqitur nga administratorët e dy shoqërive të ndërtimit përpara fillimit të shqyrtimit të ankimit kushtetues individual të tyre. Përfaqësuesi ligjor i kërkueseve është shprehur se deklarata nuk përbën kërkesë drejtuar Gjykatës dhe se ai nuk ka dijeni lidhur me të ose për revokimin e tagrave të përfaqësimit të kërkueseve prej tij në gjykimin kushtetues. Ndërkohë, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, me nismën e saj, ka paraqitur në gjykatë mendim me shkrim, duke theksuar se deklarata nuk përbën kërkesë drejtuar Gjykatës për heqjen dorë, ndaj gjykimi kushtetues duhet të vijojë, sepse çështja ka interes publik për të dhe shoqërinë në tërësi në drejtim të zhvillimit ekonomik të vendit.

19. Ndërsa subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, është shprehur se qëndrimi i përfaqësuesit ligjor të kërkueseve nuk ka asnjë vlerë juridike dhe nuk cenon thelbin e deklaratës noteriale. Lidhur me pretendimet e shoqatës, sipas Këshillit të Ministrave, ato janë të pabazuara dhe, për më tepër, kërkeset nuk legjitimohen për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

20. Në analizë të këtyre fakteve, Gjykata fillimisht vëren se Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë nuk është thirrur të marrë pjesë në gjykim nga ndonjë prej palëve pjesëmarrëse, kërkeset ose subjektet e interesuara, e po kështu as nga vetë Gjykata me nismën e saj. Në këto rrethana, kërkesa dhe parashtrimet e saj nuk mund të merren në konsideratë.

21. Në vijim, Gjykata konstaton se në përmbajtje të deklaratës noteriale, administratorët respektivë të dy shoqërive kërkuese janë shprehur për heqjen dorë nga ankimi kushtetues individual dhe se kjo deklaratë mund të paraqitet në çdo institucion. Duke mbajtur në konsideratë se administratori i shoqërisë, për shkak të ligjit, ka të drejtë dhe detyrohet të përfaqësojë shoqërinë (*shih shkronjën "b" të pikës 3 të nenit 95 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar*) dhe se vullneti për heqjen dorë është deklaruar përpara noterit publik, administratorët kanë vepruar brenda tagrave të tyre ligjore dhe nuk ka vend për të dyshuar për vullnetin e shprehur qartë prej tyre. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkeset, përmes administratorëve të tyre, bazuar në parimin e disponibilitetit të ankimit kushtetues individual me anë të heqjes dorë kanë ushtruar të drejtën e njohur nga ligji për të ndërprerë procedurën e filluar prej tyre.

22. Po kështu, Gjykata vëren se administratorët e dy shoqërive kanë zgjedhur me prokurë të posaçme përfaqësues ligjor për gjykimin kushtetues. Në kuptim të dispozitave ligjore të përfaqësimit, përfaqësuesi kryen brenda karakterit dhe vëllimit të tagrave të dhëna nga prokura veprime juridike në emër e për llogari të personit juridik të përfaqësuar (*shih nenin 64 e vijues të Kodit Civil*). Kjo do të thotë se kalimi i të drejtave të përfaqësuesit nuk ndalon të përfaqësuarin t'i ushtrojë personalisht të drejtat që atij ia njeh ligji. Për këtë arsye, mungesa e dijenisë së përfaqësuesit për aktin e heqjes dorë ose mosrevokimi eventual i aktit të përfaqësimit nuk ndikon në vlefshmërinë e aktit të heqjes dorë të kërkueseve nga ankimi kushtetues individual, për sa kohë bëhet fjalë për një të drejtë të cilën ligji, bazuar në parimin e disponibilitetit të ankimit, ua njeh atyre personalisht.

23. Për sa më lart, deklarata noteriale e paraqitur nga administratorët e dy shoqërive të ndërtimit përbën akt të heqjes dorë nga ankimi kushtetues të paraqitur rregullisht përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes, që, si rregull, passjell pushimin e gjykimit, ndaj Gjykata do të analizojë çështjen e dytë, nëse shqyrtimi i çështjes ka interes publik që përjashtimisht lejon vazhdimin e gjykimit.

24. Nga përmbajtja e pretendimeve të parashtruara në kërkesë nga kërkeset dhe prapësimeve të subjekteve të interesuara, Gjykata konstaton se çështja lidhet me të drejtën e pronës dhe lirinë ekonomike të një kategorie të veçantë individësh – shoqëri tregtare që veprojnë në fushën e

ndërtimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar rëndësia e së drejtës së pronës, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si një prej aspekteve më thelbësore të shoqërisë demokratike (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 36, datë 21.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, e garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, e cila përbën jo vetëm parim themelor të organizimit shtetëror, por edhe pjesë të katalogut të të drejtave të njeriut (*shih vendimet nr. 89, datë 28.12.2017; nr. 17, datë 27.3.2012; nr. 10 datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vë në dukje, nga njëra anë, se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, ankimi kushtetues individual mund të paraqitet vetëm për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore, ndaj për të verifikuar ekzistencën e interesit publik për vazhdimin e shqyrtimit të çështjes konkrete, ku kërkueset kanë hequr dorë, nuk mjafton thjesht dhe vetëm fakti që çështja ka lidhje me të drejtat themelore të tyre. Në këto rrethana, Gjykata çmon se nuk ka arsye bindëse se vazhdimi i gjykimit paraqet interes publik,¹ ndaj nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit. Për pasojë, gjykimi i çështjes duhet të pushohet, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 131, pika 1, shkronja “F” të Kushtetutës, si dhe neneve 31/b, 43/b, pika 2 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të heqjes dorë nga kërkesa.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 8.7.2024.

Shpallur, më 17.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

¹ Gjyqtaret Fiona Papajorgji dhe Sonila Bejtja votuan për vazhdimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se ajo paraqet interes publik.